



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KOMISIONERËT PUBLIKË**

Nr. 47/7 prot.

Tiranë, më 8.2.2022

- Lënda:** Ankim i Komisionerit Publik kundër vendimit nr. 491, datë 21.12.2021, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, për subjektin e rivlerësimit z. Gjon Kodra
- Baza ligjore:** Neni 179/b, pika 5 e Kushtetutës, neni C, pika 2, neni F, pika 2 e aneksit të Kushtetutës, neni 63 i ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”
- Për kompetencë:** Kolegjit të Posaçëm të Apelit, pranë Gjykatës Kushtetuese
- Për dijeni:** Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit (ONM)
- Depozituar pranë:** Komisionit të Pavarur të Kualifikimit

Të nderuar zonja/zotërinj, gjyqtarë të Kolegjit të Posaçëm të Apelit, pranë Gjykatës Kushtetuese;

Në zbatim të nenit 55, pika 7 e ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në RSH”, pranë Institucionit të Komisionerëve Publikë, më datë 24.1.2022, është njoftuar vendimi nr. 491, datë 21.12.2021, i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, për subjektin e rivlerësimit z. Gjon Kodra, prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Ndaj këtij vendimi, bazuar në nenin B, pika 3, germa “c”, të aneksit të Kushtetutës dhe nenit 65, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, pranë Institucionit të Komisionerëve Publikë, më datë 25.1.2022, është depozituar akti “Rekomandim për paraqitje ankimi”, nënshkruar nga një komision prej tre vëzhguesish ndërkombëtarë të Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit (në vijim referuar ONM).

Komisioneri Publik, në mbështetje të nenit C, pika 2, nenit F, pika 2, të aneksit të Kushtetutës dhe nenit 63, pika 1, të ligjit nr. 84/2016, ka të drejtë të ankimojë vendimin brenda afatit 15-ditor nga njoftimi.

Brenda afatit ligjor, unë, Komisioneri Publik Florian Ballhysa ushtroj ankim ndaj vendimit nr. 491, datë 21.12.2021, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

## **I. Procesi i rivlerësimit dhe përfundimet e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit**

1. Subjekti i rivlerësimit, z. Gjon Kodra, prej vitit 1997 e në vijim, ushtron detyrën e prokurorit në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe, në zbatim të pikës 3, të nenit 179/b, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, i është nënshtruar procesit të rivlerësimit *ex officio*.

2. Bazuar në nenin Ç, pika 1, e aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016, procesi i rivlerësimit për subjektin z. Gjon Kodra ka përfshirë kontrollin dhe rivlerësimin e të tria kritereve, atë të pasurisë, të figurës dhe të aftësive profesionale. Për këtë qëllim, Komisioni i Pavarur të Kualifikimit (në vijim referuar si Komisioni), ka administruar raportet e vlerësimit për këtë subjekt nga institucionet ndihmëse, Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim referuar si ILDKPKI), Drejtoria e Sigurimit të Informacionit (në vijim referuar si DSIK) dhe raportin e vlerësimit profesional nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë (në vijim referuar si KLP), nga të cilat rezulton se:

2.1 ILDKPKI-ja, bazuar në nenin 33, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, me anë të “*Aktit të përfundimit të kontrollit të plotë të deklarimit të pasurisë për subjektin Gjon Kodra*”, ka referuar për subjektin, se:

- i. *Deklarimi nuk është i saktë në përputhje me ligjin;*
- ii. *Ka mosdeklarim pasurie ndër vite dhe ka mungesë dokumentacioni justifikues ligjor;*
- iii. *Nuk ka kryer fshehje të pasurisë;*
- iv. *Nuk ka kryer deklarim të rremë;*
- v. *Subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.*

2.2 DSIK-ja, bazuar në nenin 39, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, fillimisht, me anë të raportit mbi kontrollin e figurës, me nr. \*\*\* prot., datë \*\*.11.2017<sup>1</sup>, ka referuar për subjektin e rivlerësimit: “*Përshtatshmerinë për vazhdimin e detyrës*”. Në vijim, me kërkesë të Komisionit, DSIK-ja ka përcjellë raportin e dytë të përditësuar me nr. \*\*\* prot., datë \*\*.10.2021<sup>2</sup>, me anë të të cilit, në mënyrë të përmbledhur, informon se: “*Informacionet e ardhura nga institucionet e verifikimit në kohështrirje përpara periudhës së rivlerësimit na bëjnë me dije: ‘Subjekti i rivlerësimit ka pasur një kontakt të papërshtatshëm me një person të përfshirë në trafikun e lëndëve narkotike, ku dyshohet se z. Kodra mund të jetë përfshirë edhe vetë në këtë aktivitet’... Në konfirmim të konstatimit fillestar për përshtatshmerinë në vijimin e ushtrimit të detyrës për subjektin e rivlerësimit Gj. Kodra, gjykojmë që për rastin në fjalë konkluzioni të mbetet në vlerësimin tuaj nën dritën e informacioneve të tjera që mund të dispononi...”.*

2.3 KLP-ja, bazuar në nenin 43, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, për kontrollin e aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit, z. Kodra, ka hartuar një raport të hollësishëm, të cilin ia ka përcjellë Komisionit.

<sup>1</sup> Deklasifikuar plotësisht me vendimin e Komisionit të Deklasifikimit dhe Zhvlerësimit të Informacionit të Klasifikuar (KDZH) nr. \*\*\*, datë \*\*.7.2021.

<sup>2</sup> Deklasifikuar pjesërisht me vendimin e KDZH-së, nr. \*\*\*, datë \*\*.10.2021.

**3.** Përfundimet e Komisionit për secilin kriter kontrolli, në mënyrë të përmbledhur, janë si vijon:

**3.1 Për vlerësimin e pasurisë.** Referuar nenit D, të aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016, Komisioni, pasi ka hetuar dhe vlerësuar gjendjen pasurore të subjektit të rivlerësimit dhe personave të lidhur me të, saktësinë dhe mjaftueshmërinë e deklarimeve periodike të interesave pasurorë krahasuar me atë “Vetting”, ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurisë, të ardhurat, shpenzimet dhe pagimin e detyrimeve financiare, ka arritur në përfundimin se subjekti i rivlerësimit: [...] *Ka kryer deklaram të mjaftueshëm dhe në vlerësim tërësor të saktë të pasurisë, duke u konstatuar pasaktësi të karakterit minimal (mosdeklarimi i pjesës takuese të pasurive të luajtshme e të paluajtshme të tij dhe të bashkëshortes, dhe mosdeklarimi i burimit të krijimit/të ardhurave në deklaratat e pasurisë), konsiderohen si pasaktësi me peshë minimale dhe që nuk kanë pasur për qëllim fshehje pasurie. Nga analiza financiare rezulton se me të ardhurat e fituara dhe shpenzimet e kryera, subjekti dhe personi i lidhur me të, bashkëshortja, kanë rezultuar me mungesë burimesh të ligjshme në shumën 908,163 lekë, për periudhën 2003-2016, balancë e cila, bazuar në parimin e proporcionalitetit, nuk përbën shkak të mjaftueshëm për aplikimin e masës disiplinore të shkarkimit të subjektit të rivlerësimit, sipas pikës 1, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016 [...]³.*

**4. Për kontrollin e figurës.** Referuar nenit DH, të aneksit të Kushtetutës dhe nenit 39, të ligjit nr. 84/2016, Komisioni, pasi ka administruar dhe analizuar: (i) dy raportet e përgatitura nga DSIK-ja, (ii) *Gjetjen* e datës 8 nëntor 2021, së bashku me aneksin (dokumente që i janë vënë në dispozicion vëzhguesit ndërkombëtar nga autoriteti shtetëror i një vendi të huaj), paraqitur nga ana e një vëzhguesi ndërkombëtar të ONM-së, (iii) provat e administruara dhe (iv) shpjegimet e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, për të provuar të kundërtën, në mënyrë të përmbledhur, ka arritur në përfundimin se: [...] *nisur nga vlerësimi tërësor i rrethanave, fakteve, provave dhe shpjegimeve të subjektit të rivlerësimit, në lidhje me kriterin e figurës, vlerëson se, pavarësisht se shtetasi \*\*\*.\*\*\* rezulton të ketë qenë person i përfshirë në krimin e organizuar, nuk rezulton e provuar në mënyrë të pakundërshtueshme që ky person të ketë qenë një kontakt i papërshtatshëm për subjektin e rivlerësimit. Ekzistenca e një telefonate në janar të vitit 2008 nga shtetasi \*\*\*.\*\*\*, në drejtim të subjektit, përveçse kohës së largët kur ka ndodhur dhe faktit se shtetasi \*\*\*.\*\*\*, ka ndërruar jetë në vitin 2011, konstatohet të jetë një dhe e vetme dhe, për rrjedhojë, rastësore dhe nuk është vërtetuar që subjekti të ketë pasur kontakte të tjera të drejtpërdrejta apo të tërthorta dhe në vazhdimësi me këtë shtetas, si dhe fakti që në kohën e telefonatës në vitin 2008 nuk kishte asnjë informacion që shtetasi \*\*\*.\*\*\* ishte i përfshirë në veprimtari kriminale të trafikut ndërkombëtar të drogës... Komisioni vlerëson se subjekti i rivlerësimit ka arritur një nivel të besueshëm për kriterin e figurës dhe sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të aneksit të Kushtetutës, duke konfirmua kështu përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës [...]⁴.*

**5. Për vlerësimin e aftësive profesionale.** Referuar nenit E, të aneksit të Kushtetutës, nenit 43/2 dhe 44 të ligjit nr. 84/2016, si dhe kreut II të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në RSH”, të ndryshuar, Komisioni, pasi ka analizuar raportin e

<sup>3</sup> Për më tepër referohuni në f. 66-67, të vendimit të Komisionit.

<sup>4</sup> Për më tepër referohuni në f. 59-60, të vendimit.

përgatitur nga KLP-ja, hetimit dhe vlerësimit të denoncimeve nga publiku dhe rekomandimin nga ana e relatorit të çështjes, ka konkluduar se subjekti i rivlerësimit ka arritur nivel kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale.

**6. Vendimi i Komisionit.** Nisur nga përfundimet e mësipërme për secilin kriter kontrolli, trupi gjykues i Komisionit, bazuar në nenin 58, pika 1, germa “a” dhe nenin 59, të ligjit nr. 84/2016, ka vendosur (ndër të tjera, si pjesë e dispozitivit): [...] Konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit, z. Gjon Kodra, prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë [...].

## **II. Rekomandimi i Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit (ONM)**

**7.** Bazuar në nenin B, pika 3, germa “c<sup>5</sup>”, të aneksit të Kushtetutës dhe nenit 65/2<sup>6</sup>, të ligjit nr. 84/2016, një komision i përbërë nga tre përfaqësues të ONM-së, më datë 25.1.2022, kanë paraqitur pranë Institucionit të Komisionerëve Publikë, “Rekomandim për paraqitje ankimi” ndaj vendimit nr. 491, datë 21.12.2021, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, që i përket subjektit të rivlerësimit z. Gjon Kodra (bashkëlidhur këtij ankimi).

7.1 Në mënyrë të përmbledhur, vëzhguesit ndërkombëtarë, me paraqitjen e këtij rekomandimi, vlerësojnë se, nga një rivlerësim korrekt i të gjitha çështjeve, procesi në rastin konkret duhet të konkludojë në shkarkimin e subjektit të rivlerësimit, pasi ky i fundit: (i) nuk arrin nivelin e besueshmërisë në vlerësimin e kriterit të pasurisë, referuar nenit 59, pika 1, germa “a”, të ligjit nr. 84/2016; (ii) është gjendur në situatën e konfliktit të interesave gjatë hetimit të një çështje penale, si dhe për sa i përket kontrollit të figurës; (iii) duhet marrë në konsideratë *gjetja* e vëzhguesit ndërkombëtar e datës 8 nëntor 2021 dhe e aneksit përkatës, në kuadër të një vlerësimi tërësor të çështjes, referuar nenit 61, pika 5, të ligjit nr. 84/2016.

## **III. Gjetja e vëzhguesit ndërkombëtar të ONM-së, paraqitur gjatë hetimit administrativ të Komisionit**

**8.** Bazuar në nenin B, pika 3, germa “b<sup>7</sup>”, e aneksit të Kushtetutës dhe në nenin 49, pika 10, të ligjit nr. 84/2016, rezulton se gjatë hetimit administrativ që i përket subjektit të rivlerësimit z. Gjon Kodra, Komisioni ka administruar një gjetje, të datës 8.11.2021, së bashku me aneksin (dokumente që i janë vënë në dispozicion vëzhguesit ndërkombëtar nga autoritetet përkatëse italiane), paraqitur nga vëzhguesi ndërkombëtar i ONM-së, lidhur me vlerësimin e kriterit të kontrollit të figurës të subjektit të rivlerësimit.

## **IV. Vlerësimi i Komisionerit Publik**

**9.** Në kuptim të nenit 179/b të Kushtetutës, aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, Komisioneri Publik është një nga tri institucionet e ngarkuara për kryerjen e procesit të rivlerësimit kalimtar (Vetting).

---

<sup>5</sup> Vëzhguesi ndërkombëtar ushtron këto detyra: “... u jep Komisionerëve Publikë rekomandime me shkrim për të paraqitur ankim. Në rast se Komisioneri Publik nuk i zbaton rekomandimet, ai përgatit një raport me shkrim, duke dhënë arsyet e refuzimit”.

<sup>6</sup> Vëzhguesi ndërkombëtar ka të drejtë të paraqesë rekomandim me shkrim Komisionerit Publik për të paraqitur ankim. Ky rekomandim jepet nga një komision i përbërë nga të paktën 3 përfaqësues të ONM-së.

<sup>7</sup> Vëzhguesi ndërkombëtar ushtron këto detyra: ... “Paraqet gjetje dhe mendime mbi çështje që shqyrtohen nga Komisioni dhe nga Kolegji i Apelit, si dhe kontribuon ...”.

10. Bazuar në këto parashikime kushtetuese dhe ligjore, Komisionerit Publik, si përfaqësues i interesit publik në kryerjen e këtij procesi, i njihet e drejta e ankimit kundër vendimeve të Komisionit dhe paraqitjen e tyre juridiksionit rivlerësues të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit (në vijim referuar si Kolegji).

11. Në krahasim me kompetencat e njohura për Komisionin dhe Kolegjin, nga neni Ç i aneksit të Kushtetutës dhe nenet 48-52 të ligjit nr. 84/2016, Komisioneri Publik është i detyruar që kompetencën e tij për të ushtruar ankim ndaj vendimeve të Komisionit, ta mbështesë vetëm në aktet dhe provat e administruara gjatë hetimit administrativ të kryer nga Komisioni.

12. Në të tilla rrethana ligjore, me qëllim garantimin e mbrojtjes së interesit publik gjatë procesit të rivlerësimit, Komisioneri Publik ka detyrimin që të ushtrojë kontroll mbi vendimet e dhëna nga Komisioni, duke vlerësuar nëse vendimmarrja e tij është në përputhje me kërkesat kushtetuese e ligjore, bazohet në një hetim administrativ të gjithanshëm e shterues dhe vlerësim të drejtë të provave të administruara.

13. Edhe në rastin konkret, Komisioneri Publik, mbështetur në kompetencën e tij kushtetuese dhe ligjore, në zbatim dhe të Rekomandimit të paraqitur nga ONM-ja, konstaton se nga shqyrtimi i vendimit nr. 491/2021, të Komisionit dhe akteve shoqëruese të tij, paraqiten rrethana të tilla ligjore e fakti, për të cilat çmon se ky vendim është i cenusshëm në tërësinë e tij, si dhe përmban shkaqe të mjaftueshme ligjore për t'iu paraqitur juridiksionit kontrollues dhe rivlerësues të Kolegjit.

14. Sa më sipër, në zbatim dhe të përmbajtjes së Rekomandimit të paraqitur nga ONM-ja, Komisioneri Publik, referuar dispozitave të aneksit të Kushtetutës dhe ligjit të posaçëm nr. 84/2016, konstaton se përfundimet e arritura nga Komisioni nuk janë të drejta dhe në pajtueshmëri me provat e administruara.

15. Komisioneri Publik, nëpërmjet këtij mjeti procedural (ankimit), në respektim të kërkesave kushtetuese e ligjore për rivlerësimin kalimtar të subjekteve dhe në mbrojtje të interesit publik, synon kontrollin e vendimit nr. 491/2021, të Komisionit nga ana e Kolegjit, lidhur me nevojën e rivlerësimit të çështjeve të ngritura në këtë ankim për të tria kriteret, atë të pasurisë, të figurës, të aftësisë profesionale (etika në lidhje me situatën e konfliktit të interesit) dhe vlerësimin tërësor të çështjes.

16. Duke përfunduar, bazuar në nenin C, pika 2, nenin F, pikat 3 dhe 7, të aneksit të Kushtetutës, si dhe nenin 4 dhe 66 të ligjit nr. 84/2016, ky ankim i Komisionerit Publik ndaj vendimit nr. 491, datë 21.12.2021, të Komisionit, ushtrohet për të tria kriteret e rivlerësimit.

## **V. Analiza e shkaqeve të ankimit**

### **V.A. Për kontrollin e pasurisë**

17. Për sa i takon rivlerësimit të kriterit të pasurisë, referuar nenit D, të aneksit të Kushtetutës dhe neneve 30 - 33 të ligjit nr. 84/2016, Komisioneri Publik mban në konsideratë se, gjatë kryerjes së procedurave të rivlerësimit, objekti i hetimit dhe i vlerësimit të pasurisë ndaj subjekteve që i nënshtrohen këtij procesi, sipas nenit 179/b të Kushtetutës, materializohet në kontrollin e saktësisë dhe mjaftueshmërisë së deklarimeve të subjektit ("Vetting" dhe ato periodike), ku në çdo rast subjekti i rivlerësimit duhet të deklarojë tërësinë e pasurisë së tij dhe

shpjegojë bindshëm ligjshmërinë e burimit të krijimit të saj, si dhe ekzistencën e të ardhurave të ligjshme, sipas përkufizimit kushtetues.

**18.** Nga aktet e administruara dhe përmbajtja e vendimit të Komisionit, rezulton se gjatë hetimit administrativ të kriterit të pasurisë, subjektit të rivlerësimit i janë kërkuar shpjegime dhe i është kaluar barra e provës, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, pasi janë konstatuar problematika mbi saktësinë, mjaftueshmërinë dhe ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurive, të subjektit të rivlerësimit dhe personave të lidhur me të.

**19.** Interesat privatë dhe pasurorë, të deklaruar nga subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të, janë deklaruar fillimisht në *“Deklaratën e personit, që mbart detyrimin për deklarim pasurie”* dorëzuar në ILDKPKI më datë 26.3.2004, dhe në vijim në deklaratat periodike për vitet 2004 - 2016 (këtu e në vijim referuar si DV-20...) dhe në Deklaratën *“Vetting”* (këtu e në vijim referuar si D-Vett.), dorëzuar në ILDKPKI në datën 20.1.2017. Nga shqyrtimi dhe krahasimi i deklaratave si më sipër, referuar nenit 32, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, në funksion të nenit D, të aneksit të Kushtetutës, pasuritë për të cilat paraqesim shkaqe ankimi janë:

**20.** *Pasuria “Apartament me sip. 129 m<sup>2</sup>”, ndodhur në Rrugën e \*\*\*, Tiranë (në vijim referuar si “Apartament me sip. 129 m<sup>2</sup> Tiranë”)*

20.1 *Në Deklaratën “Vetting”, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: “Apartament me sipërfaqe 129 m<sup>2</sup>, ndodhur në katin e \*\*\* të banesës me nëntë kate, Rruga e \*\*\*, pallati \*\*\* sh.p.k., hyrja nr. \*\*, apartamenti nr. \*\*. Blerë me kontratë shitblerjeje nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë \*\*.10.2016, vërtetuar me certifikatën e pronësisë nr. \*\*\*, datë \*\*.10.2016. Nga rimatja e objektit para përpilimit të kontratës përfundimtare ka rezultuar 11 metër më shumë sesa është pasqyruar në kontratën e shitblerjes së mëparshme 118 m<sup>2</sup>. Vlera e kësaj difference do të zgjidhet me marrëveshje me investitorin e objektit në të ardhmen. Ky apartament është deklaruar më parë në kontratën e shitblerjes dhe vërtetimit përkatës të noterit \*\*\*,\*\*\*”. Vlera: 50.952 euro. Pjesa takuese: 100%.*

Burimi i krijimit nuk është deklaruar.

20.2 *Në DV-2006, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: “Prenotim apartamenti me sip. 115.8 m<sup>2</sup>, sipas kontratës së sipërmarrjes me shoqërinë \*\*\* sh.p.k., me vlerë 50.952 euro, me adresë: Rruga “\*\*\*\*”, pallati 9-katësh pas ambulancës. Paguar deri më \*\*.12.2006 shuma 35.952 euro. Duke përdorur kursime të deklaruara më parë në vitet 2005 - 2006, si dhe shumën prej 30.000 euro nga të ardhurat e bashkëshortes. Vlera: 50.952 euro. Pjesa takuese 50%. Në të njëjtën deklaratë në rubrikën: “Të ardhurat dhe angazhimet në veprimtari private dhe publike”, subjekti ka deklaruar: “Të ardhura nga bashkëshortja \*\*\* \*\*\*(shtetase italiane) nga viti 1980 deri në vitin 1999, kursime nga puna shumëvjeçare në Itali dhe për periudhën 8-vjeçare në Shqipëri (Shkodër), si përfaqësuese e firmës italiane. Shuma 35.000 euro.*

20.3 *Në DV-2007, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: “Paguar gjatë vitit 2007 shuma 5.000 euro për apartamentin e prenotuar sipas deklaramit të mëparshëm. Shuma e shlyer: 5.000 euro. Gjendja e detyrimit të mbetur deri në 31 dhjetor të vitit të deklaramit: 10.000 euro. Nuk deklarohet burimi i krijimit për këtë pagesë.*

20.4 Në DV-2008, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: “*Paguar gjatë vitit 2008 shuma 10.000 euro për apartamentin e prenotuar në vitin 2006 me shoqërinë \*\*\*\* sh.p.k. Shuma e shlyer: 10.000 euro. Gjendja e detyrimit të mbetur: 0*”. Nuk deklarohet burimi i krijimit për këtë pagesë.

20.5 Agjencia Shtetërore e Kadastrës (ASHK), me shkresat nr. \*\*\* prot., datë \*\*.5.2020, dhe nr. \*\*\* prot., datë \*\*.8.2021, konfirmon se në emër të subjektit të rivlerësimit figuron e regjistruar pasuria apartament me sip. 129 m<sup>2</sup>, me numër pasurie \*\*\*, \*\*\*.\*\*\*, \*\*\*, vol. \*\*, f. 174. Bashkëlidhur kësaj shkrese janë administruar:

(i) Kontratë shitblerje nr. \*\*\* rep. dhe nr. \*\*\* kol., datë \*\*.10.2016, lidhur midis shoqërisë “\*\*\*\*” sh.p.k., e përfaqësuar nga administratori z. \*\*\* \*\*\*, në cilësinë e shitësit, dhe subjektit të rivlerësimit z. Gjon Kodra, në cilësinë e blerësit. Në nenin 4 të kësaj kontrate përcaktohet se pasuria objekt kontrate do të shitet për vlerën 50.952 euro. Shumë e cila është likuiduar totalisht;

(ii) Kontratë (e titulluar) shitblerje (*Komisioni në vendim i referohet si kontratë sipërmarrje*), pa datë, e vitit 2006 (kjo kontratë nuk ka elementet përkatëse të numrit të repertorit dhe koleksionit, si dhe pa nënshkrimin dhe vulën e noterit), për pasuri të paluajtshme apartament me sip. 115.8 m<sup>2</sup>, lidhur midis shoqërisë “\*\*\*\*” sh.p.k., e përfaqësuar nga administratori z. \*\*\* \*\*\* dhe subjektit të rivlerësimit, z. Gjon Kodra. Në këtë akt specifikohet se palët janë marrë vesh që pasuria apartament t’i kalojë palës blerëse për çmimin 50.952 euro, vlerë e cila është likuiduar plotësisht nga pala blerëse në favor të asaj shitëse.

20.6 Lidhur me burimin e krijimit të kësaj pasurie, nga vlerësimi i akteve të administruara, rezultojnë rrethanat si vijon: (i) Në Deklaratën “Vetting”, subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar burimin e krijimit; (ii) Në deklaratën e personit që mbart detyrimin për deklarim pasurie, dorëzuar nga subjekti në ILDKPKI në datën 26.3.2004 dhe deklaratat periodike vjetore për vitet 2004 dhe 2005 rezulton se subjekti i rivlerësimit dhe/ose personi i lidhur, bashkëshortja, nuk kanë deklaruar kursime *cash*; (iii) Në DV-2006, subjekti ka deklaruar pagesën në shumën 35.952 euro me burim kursime të deklaruara më parë në vitet 2005-2006, si dhe shumën prej 30.000 euro nga të ardhurat e bashkëshortes; (iv) Në DV-2007, subjekti ka deklaruar pagesën në shumën 5.000 euro, por nuk ka deklaruar burimin e krijimit të kësaj shume; (v) Në DV-2008, subjekti ka deklaruar pagesën e shumës 10.000 euro, por nuk ka deklaruar burimin e krijimit të kësaj shume.

20.7 Për pagesat e kryera në vitet 2007 dhe 2008, respektivisht në shumat 5.000 euro dhe 10.000 euro, në përgjigje të Pyetësorit nr. 3, subjekti, ndër të tjera, ka deklaruar: [...] *Nuk më kujtohen datat e pagesave të mësipërme të cilat janë kryer në vitet respektive 2007 e 2008 ... shuma prej 5.000 euro, e paguar në vitin 2007, është e ardhur nga kursimet e bashkëshortes sime gjatë viteve dhe, konkretisht, në deklaratën periodike vjetore 2006 është deklaruar si të ardhura të bashkëshortes nga viti 1980 deri në vitin 1999 shuma prej 35.000 euro. Edhe në vitin 2008 është paguar shuma prej 10.000 euro, burimi i së cilës është sqaruar dhe në deklaratimet e bëra në vite [...].*

20.8 Për sa më sipër, lidhur me pasurinë “*Apartament me sip. 129 m<sup>2</sup> Tiranë*”, Komisioni, ndër të tjera, i ka kaluar subjektit të rivlerësimit barrën e provës për faktet e konstatuara:

- (i) *Duket se nga llogaritja e mundësisë financiare për kursim (të ardhura-shpenzime), në mungesë të deklarimeve periodike të bashkëshortes për vitet 2003 - 2005, këto kursime mbeten të paprovuara dhe deri në këto momente Komisioni nuk i ka marrë në konsideratë ato. Ju, si subjekt i rivlerësimit, keni detyrimin të shpjegoni qëndrimin tuaj në raport me legjislacionin në fuqi;*
- (ii) *Duket se subjekti i rivlerësimit ka mungesë burimesh të ligjshme për pagesën e kryer për apartamentin në vitin 2007, në shumën 5,000 euro;*
- (iii) *Duket se subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar në DIPP-në e 2008 burimin e pagesës së kryer për apartamentin në shumën 10,000 euro, por nga analiza financiare për këtë vit duket se ka mungesë burimesh të ligjshme.*

**21.** Në përgjigje të barrës së provës, subjekti i rivlerësimit ka dhënë përgjigje dhe ka paraqitur dokumentacion për të provuar të kundërtën<sup>8</sup> dhe, ndër të tjera, ka deklaruar: [...] *Duke pasur parasysh se në vitet e para të deklarimeve 2003-2004-2005 ka pasur shumë paqartësi në mënyrën e plotësimit të deklarimeve, unë, në të gjitha deklaratimet, e kam plotësuar saktë në përbërjen familjare, ndonëse znj. \*\*\* sipas legjislacionit shqiptar nuk rezulton të jetë e regjistruar (si bashkëshorte) në Regjistrin e Gjendjes Civile në Shqipëri ... legjislacioni dhe vetë ILDKP e kishte të paqartë nëse duhej të deklaronte një shtetase e huaj, e cila në shtetin italian zotëronte pasuri të përbashkët me prindërit (të trashëguar), zotëronte pasuri të luajtshme dhe likuiditetet, të ardhura nga punësimi i saj nga viti 1980 e në vijim etj.[...].*

21.1 Komisioni, pasi ka marrë në konsideratë shpjegimet dhe provat e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit për të kundërtën e barrës së provës, ndër të tjera, ka arritur në përfundimin se: [...] *Mosdeklarimi i të ardhurave të bashkëshortes dhe i kursimeve të saj në deklaratat e pasurisë në vitet 2004 - 2005, që në fakt janë deklaruar në DIPP-në e vitit 2006 e në vazhdim prej vitit 2008, përfshirë edhe në Deklaratën “Vetting”, dokumente që, në kuptim të nenit 32 të ligjit nr. 84/2016, kanë vlerën e provës, por që nga ana tjetër provohet bindshëm mundësia e bashkëshortes për kursimin e shumës 35,000 euro, konsiderohet nga Komisioni si pasaktësi në deklaram, e cila nuk vlerësohet deri në atë masë sa të aplikohet masa disiplinore e shkarkimit nga detyra<sup>9</sup> [...]. Ndërsa për pamjaftueshmërinë e konstatuar për vitin 2008, Komisioni ka vlerësuar se subjekti nuk ka dhënë shpjegime bindëse.*

**22.** Komisioneri Publik, në analizë të situatës faktike të përshkruar më sipër, për pasurinë *Apartament me sip. 129 m<sup>2</sup>*, vlerëson se përfundimi i arritur nga Komisioni nuk gjen mbështetje në provat e administruara, ligjin e zbatueshëm, si dhe jurisprudencën e Kolegjit, për arsytet si vijon:

**23.** *Lidhur me pagesën e shumës 35.952 euro në vitin 2006, me burim kursime të deklaruar më parë në vitet 2005-2006 dhe 30.000 euro nga të ardhurat e bashkëshortes*

<sup>8</sup> Referohuni përgjigjeve të subjektit në aktin: “*Shpjegime dhe dokumentacion mbi relacionin e KPK-së për subjektin z. Gjon Kodra*”.

<sup>9</sup> Për më tepër referohuni arsytimit në f. 22-23, të vendimit të Komisionit.



23.1 Sikundër është konstatuar edhe gjatë hetimit administrativ të Komisionit, subjekti i rivlerësimit ka lidhur martesë ligjore me shtetasen \*\*\*.\*\*\* (shtetase italiane), në vitin 1999, duke e deklaruar rregullisht në përbërjen familjare në deklaratat periodike ndër vite.

23.2 Referuar deklaratës së personit që mbart detyrimin për deklarim pasurie, dorëzuar nga subjekti në ILDKPKI në datën 26.3.2004 dhe deklaratave periodike vjetore për vitet 2004 dhe 2005, rezulton se në këto deklarata subjekti i rivlerësimit dhe/ose personi i lidhur, bashkëshortja, nuk kanë deklaruar posedimin e kursimeve *cash* në shumën 35.000 euro, me burim të ardhurat nga punësimi i bashkëshortes.

23.3 Nga verifikimi i llogarive bankare të bashkëshortes së subjektit të rivlerësimit nuk rezulton që këto kursime të pretenduara të kenë qenë gjendje në llogaritë e saj bankare. Gjithashtu, subjekti gjatë hetimit administrativ nuk ka arritur të provojë mënyrën e transferimit të këtyre kursimeve në Shqipëri<sup>10</sup>.

23.4 Referuar parashikimeve të ligjit nr. 9049/2003, datë 10.4.2003, “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, subjekti i rivlerësimit ka pasur detyrimin për deklarimin e pasurive të personit të lidhur, bashkëshortes së tij. Më konkretisht në nenin 4, germa “d”, të këtij ligji përcaktohet se subjekti detyrohet të deklarojë: *“vlerën e likuiditeteve, gjendje në cash, në llogari rrjedhëse, në depozitë, në bono thesari dhe në huadhënie, në lekë ose në valutë të huaj”*. Ndërsa në nenin 22 të këtij ligji përcaktohet: *“Kur pasuria e pjesëtarëve të familjes është e ndarë dhe e regjistruar si e tillë në organet e administratës shtetërore ose gjyqësore, deklarimi paraqitet veçmas nga çdo anëtar i familjes, me pasuri të regjistruar në emër të vet dhe i bashkëlidhet deklaratës së personit që ka detyrimin për deklarim”*.

23.5 Në analizë të sa më sipër, konstatohet se legjislacioni në fuqi që përcakton mënyrën, llojin, objektin dhe afatin e deklarimit të pasurisë dhe interesave privatë ka rregullim të posaçëm në drejtim të përcaktimit të detyrimit për deklarim dhe mënyrës së deklarimit, qëllimi i të cilit është të monitorojë deklarimin dhe kontrollin e pasurisë për subjektet deklarues dhe personat e lidhur me ta. Referuar këtij konstatimi, pretendimet e subjektit të rivlerësimit se ka pasur paqartësi në lidhje me plotësimin e formularëve të deklarimit lidhur me personat e lidhur, nuk gjejnë mbështetje në rrethana objektive.

23.6 Komisioneri Publik, nga shqyrtimi i akteve në dosje, si dhe në zbatim të Rekomandimit të ONM-së, datë 25.1.2022, germa “a”, vëren se: (i) Në deklaratat e pasurisë për vitet 2003-2005, subjekti i rivlerësimit dhe/ose personi i lidhur, nuk kanë deklaruar posedimin e kursimeve *cash* në shumën 35.000 euro. (ii) Në dosjen e Komisionit nuk është administruar asnjë provë/akt, që të provojë posedimin e kursimeve në shumën 35.000 euro nga subjekti dhe personi i lidhur me të, apo transferimit të kësaj shume drejt Shqipërisë. Për rrjedhojë, në vlerësimin e Komisionerit Publik kjo shumë nuk duhet përfshirë në analizën e burimeve të ligjshme që kanë shërbyer për blerjen e pasurisë *Apartament me sip. 129 m<sup>2</sup>*.

---

<sup>10</sup> Subjekti gjatë hetimit administrativ ka deklaruar: [...] *Dokument tjetër ligjor unë nuk mund të paraqesë që të vërtetojë se ku është mbajtur kjo shumë prej 35.000 euro nga ana e bashkëshortes time, ... Me njohjen e pyetjeve të Pyetësorit nr.5, i kam kërkuar bashkëshortes që të më shpjegojë mënyrën e mbajtjes të parave në Itali dhe për mënyrën e transferimit të këtyre parave në RSH-së. Ajo më ka pohuar se transferimi i parave të tërhequra nga llogaritë bankare në shtetin italian janë bërë në përputhje me të gjitha kërkesat ligjore, si të shtetit italian dhe shtetit shqiptar [...].*

23.7 Komisioneri Publik në këtë vlerësim i referohet dhe jurisprudencës e Kolegjit lidhur me deklaratimet e likuiditeteve *cash*, që gjen pasqyrim, ndër të tjera, në vendimet e juridiksionit të rivlerësimit nr. 27/2020, nr.1/2021.

23.8 Në këto rrethana, Komisioneri Publik vlerëson se subjekti i rivlerësimit nuk ka provuar të kundërtën e barrës së provës. Si rezultat duke mos përfshirë këto likuiditete në mesin e burimeve të ligjshme, ashtu sikurse ka konstatuar dhe vetë Komisioni fillimisht, rezultoi se subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur me të nuk mbulojnë me burime të ligjshme shpenzimet, kursimet dhe pagesën e kryer në vitin 2006, në shumën 35.952 euro, për një diferencë negative në shumën - 4.021.882 lekë<sup>11</sup>.

#### **24. Lidhur me pagesën e shumës 5.000 euro në vitin 2007**

24.1 Nga aktet e administruara në dosje, rezultoi se subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur me të nuk kanë deklaruar burimin e krijimit të pagesës prej 5.000 euro, në deklaratën periodike vjetore dhe as në atë “Vetting”. Gjatë hetimit administrativ të Komisionit, subjekti i rivlerësimit ka pretenduar se shuma 5.000 euro ka si burim diferencën e mbetur nga kursimet e bashkëshortes në shumën 35.000 euro.

24.2 Komisioneri Publik, sikundër u arsyetua më lart, konstaton se shuma 5.000 euro, e pretenduar me burim kursimet e bashkëshortes, nuk mund të përfshihet në mesin e burimeve të ligjshme, për sa kohë nuk është deklaruar posedimi i kësaj shume në deklaratat periodike për vitet 2003-2005. Në vijim të këtij konstatimi, as në DV-2007, kur është deklaruar pagesa në shumën 5.000 euro, nuk rezultoi që subjekti të ketë deklaruar burimin e krijimit dhe as pakësim të likuiditeteve *cash*. Duke analizuar edhe lëvizjet e llogarive bankare të subjektit dhe bashkëshortes, konstatohet se deri në datën \*\*.7.2007<sup>12</sup>, kur është kryer kjo pagesë, janë tërhequr nga llogaritë e tyre bankare shumat rreth 1.000 euro dhe 10.000 lekë. Këto shuma janë të pamjaftueshme për mbulimin e shpenzimeve të periudhës dhe pagimin e shumës 5.000 euro.

24.3 Komisioneri Publik, bazuar dhe në orientimin e Kolegjit në vendimin (JR) nr. 7/2019, vlerëson se nuk mund të prezumohet përdorimi nga subjekti i gjendjeve *cash* si burime për krijimin e pasurive dhe mbulimin e shpenzimeve, për sa kohë një gjë e tillë nuk është deklaruar në mënyrë të qartë dhe të plotë nga vetë subjekti i rivlerësimit në deklaratat periodike. Në këto kushte, rezultoi se subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur me të nuk kanë pasur të ardhura të ligjshme të mjaftueshme për pagesën e kryer për apartamentin në vitin 2007, në shumën 5,000 euro.

#### **25. Lidhur me pagesën e shumës 10.000 euro në vitin 2008**

25.1 Nga aktet e administruara në dosje, rezultoi se subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur me të nuk kanë deklaruar burimin e krijimit të pagesës prej 10.000 euro, në deklaratën periodike vjetore dhe as në atë “Vetting”. Referuar analizës financiare të kryer nga Komisioni për vitin 2008, rezultoi se subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur me të nuk mbulojnë me

<sup>11</sup> Referohuni rezultatit financiar të Komisionit për vitin 2006, f. 35, e relacionit mbi rezultatet paraprake të hetimit administrativ për subjektin e rivlerësimit.

<sup>12</sup> Në shpjegime përfundimtare, subjekti ka paraqitur mandatpagesë nr. \*\*, datë \*\*.7.2007, për pagesën në shumën 5.000 euro.

burime të ligjshme pagesën e kryer për blerjen e apartamentit me sip. 129 m<sup>2</sup>, në vitin 2008, shpenzimet dhe kursimet e vitit, për një diferencë negative në shumën -563.752 lekë<sup>13</sup>.

26. Komisioneri Publik, në zbatim dhe të Rekomandimit të ONM-së, datë 25.1.2022, pika “2”, gjen si të nevojshme kryerjen e një analize të plotë financiare nga ana e Kolegjit për të gjitha vitet e deklarimit, në funksion të shkaqeve të këtij ankimi lidhur me kriterin e pasurisë<sup>14</sup>.

27. Duke përfunduar, Komisioneri Publik, bazuar në përcaktimet e nenit D, pikat 1 dhe 3, të aneksit të Kushtetutës, nenit 33, pika 5, germa “b”, lidhur me nenin 61, pika 3, të ligjit nr. 84/2016, vlerëson se subjekti i rivlerësimit ndodhet në kushtet e deklarimit të pasaktë dhe të pamjaftueshëm, si dhe ka mungesë të burimeve të ligjshme për krijimin e pasurisë.

#### **V.B. Ekzistenca e konfliktit të interesit**

28. Komisioni, gjatë hetimit administrativ në kuadër të procesit të rivlerësimit për pasurinë “Apartament me sip. 129 m<sup>2</sup>”, është ndalur edhe në vlerësimin për konstatimin e ndonjë situatë të mundshme të konfliktit të interesit ndërmjet subjektit të rivlerësimit dhe palës shitëse, shoqërisë “\*\*\*\*” sh.p.k., me administrator shtetasin \*\*\*.\*\*\* Nga korrespondenca e ndjekur me Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Tiranë, kjo e fundit, me anë të shkresës me nr. \*\*\* prot., datë \*\*.6.2021, ka referuar se personi juridik “\*\*\*\*” sh.p.k. dhe administratori i saj kanë pasur një sërë çështjesh penale pranë kësaj Prokurorie, ku një prej tyre, çështja penale me nr. \*\*\*, është ndjekur dhe trajtuar nga subjekti i rivlerësimit, z. Gjon Kodra.

29. Nga aktet e administruara, ka rezultuar se shtetasi \*\*\*.\*\*\* i është drejtuar Prokurorisë pranë Gjykatë së Rrethit Gjyqësor Tiranë me kallëzim kundër disa punonjësve të OSSH-së, mbi bazën e të cilit është regjistruar dhe ka filluar procedimi penal nr. \*\*\*, datë \*\*.6.2010, për veprën penale të “Shpërdorimit të detyrës”, parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal. Ky procedim penal është ndjekur nga subjekti i rivlerësimit, i cili, pasi ka ndërmarrë veprimet hetimore përkatëse, me vendimin e datës \*\*.3.2011, bazuar në nenin 328/1, germa “b”, të Kodit të Procedurës Penale, ka vendosur pushimin e çështjes. Subjekti kallëzues e ka ankimuar vendimmarrjen e subjektit të rivlerësimit në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe kjo e fundit, me vendimin nr. \*\*\* Regj., Them., datë \*\*.7.2011, ka vendosur rrëzimin e kërkesit \*\*\*.\*\*\* me objekt: “Kundërshtimin e vendimit për pushimin e çështjes penale...”.

30. Komisioni, për sa më sipër, ka konstatuar se subjekti i rivlerësimit është ndodhur në situatën e konfliktit të interesit kur ka hetuar çështjen penale me kallëzues \*\*\*.\*\*\*, me të cilin ka pasur marrëdhënie interesi, si dhe marrëdhënie shoqërore në vazhdimësi, e për rrjedhojë, bazuar në nenin 52, të ligjit nr. 84/2016, i ka kaluar barrën e provës subjektit të rivlerësimit për të provuar të kundërtën.

31. Në përgjigje të barrës së provës, subjekti i rivlerësimit, ndër të tjera, ka prapësuar se: [...] *Është e vërtetë se me shtetasin \*\*\*.\*\*\* kam lidhje shoqërore dhe familjare (prej vitit 2005), si dhe kam blerë në objektin e ndërtuar prej tij apartamentin ku banoj aktualisht... Ky*

<sup>13</sup> Referohuni rezultatit financiar të Komisionit për vitin 2008, f. 51, të vendimit.

<sup>14</sup> Në analizën financiare në rezultatet e hetimit paraprak, Komisioni, përveç pamjaftueshmërisë së konstatuar lidhur me pasurinë apartament, ka konstatuar pamjaftueshmëri edhe për vitet 2010 dhe 2011. Në vendimin përfundimtar, duket se, pasi ka bërë një vlerësim tërësor të akteve, pavarësisht deklarimeve të pasakta dhe kontradiktore të subjektit, lidhur me huadhënësin \*\*\*.\*\*\*, ka vlerësuar të përfshijë në analizë shumën 10.000 euro të marrë hua nga ky shtetas. Ndërsa ka mbetur e pandryshuar diferenca negative në vlerën -344.411 lekë, në vitin 2011.

shtetas, në vitin 2010, ka kallëzuar punonjësit e OSSH... me marrjen e këtij kallëzimi penal është kontaktuar me drejtuesin e sektorit, të cilin e kam vënë në dijeni të marrëdhënies që kam pasur dhe kam me shtetasin \*\*\*.\*\*\*. Drejtuesi ka çmuar se unë duhej të kryeja veprimet hetimore dhe nëse nga këto veprime do të konkludohej në përgjegjësi penale, do të procedohej me dorëheqje... Pra, pavarësisht se në dukje duket se ndodhemi para konfliktit të interesit, unë si prokuror nuk e kam favorizuar këtë shtetas, përkundrazi kam zgjidhur çështjen me drejtësi, pavarësisht marrëdhënieve që kam pasur e kam me të<sup>15</sup>[...].

**32.** Komisioni, për situatën faktike si më sipër, ndër të tjera, ka arritur në përfundimin: [...] Në lidhje me situatën e konfliktit të interesit, Komisioni vëren se prej vitit 2006 deri në vitin 2017, ndërmjet subjektit të rivlerësimit dhe shoqërisë “\*\*\*” sh.p.k., me administratorin dhe ortakun e vetëm \*\*\*.\*\*\*, ka ekzistuar marrëdhënie me karakter pasuror, e cila ka nisur në vitin 2006, me porositjen e një apartamenti dhe është finalizuar me kontratën e shitblerjes në vitin 2016 dhe aktmarrëveshjen në vitin 2017. Komisioni konstaton se marrëdhënia e mirëfilltë e interesit e subjektit me administratorin dhe ortakun e vetëm të shoqërisë “\*\*\*” sh.p.k., shtetasin \*\*\*.\*\*\*, ka përfunduar në vitin 2008, me pagesën e çmimit të plotë të blerjes së apartamentit prej 50,952 euro, i cili është edhe çmimi i përcaktuar në kontratën e shitblerjes përfundimtare të apartamentit në vitin 2017. Kompensimi i vlerës së sipërfaqes prej 11 m<sup>2</sup> me vlerën e punimeve të kryera në apartament nga subjekti është një element që ka lindur papritur në vitin 2017, para lidhjes së kontratës përfundimtare të shitjes, por që është zgjidhur njëkohësisht me firmosjen e kësaj kontrate në vitin 2017. Pretendimi i subjektit të rivlerësimit se ka treguar kujdesin e duhur, duke njoftuar drejtuesin e tij lidhur me marrëdhënien e miqësisë me kallëzuesin, mbetet në kuadër deklarativ dhe i paprovuar. ...Komisioni mban në konsideratë faktin se kjo marrëdhënie interesi, përveçse kishte përfunduar që në vitin 2008 (ndërkohë që çështja penale i përket periudhës 2010 – 2011), me pagesën e plotë të çmimit të blerjes nga subjekti i rivlerësimit, nuk u provua se ishte në vetvete një trajtim preferencial, që mund të konsistonte në aplikimin e një çmimi të ulët të favorshëm nga shoqëria “\*\*\*” sh.p.k., në favor të subjektit [...]<sup>16</sup>.

**33.** Komisioneri Publik, nga vlerësimi tërësor i akteve të administruara, çmon se përfundimi i arritur nga Komisioni nuk është rrjedhojë e një vlerësimi të drejtë të provave dhe ligjit të zbatueshëm. Në zbatim dhe të Rekomandimit të ONM-së, datë 25.1.2022, germa “B”, Komisioneri Publik, ndryshe nga konkluzioni i Komisionit, vlerëson se marrëdhënia e interesit ndërmjet subjektit të rivlerësimit dhe shtetasit \*\*\*.\*\*\* nuk kishte përfunduar në vitin 2008, por ajo ka vazhduar në vitin 2010, dhe më tej në vitin 2016, kur u finalizua dhe kontrata e shitblerjes.

**33.1** Në vlerësimin e këtij rasti, shqyrtimi nuk qëndron vetëm në kufijtë e konstatimit të një trajtimi preferencial, qoftë ai me përfitime të dyanshme mes palëve, pasi trajtimi preferencial jo domosdoshmërisht lidhet me konfliktin e interesit dhe mund të ekzistojë edhe pa provuar atë gjendje. Prandaj, arsyetimi i Komisionit se nuk u provua trajtimi preferencial në çmimin e apartamentit apo se vendimmarrja e subjektit të rivlerësimit në pushimin e çështjes penale ku subjekt iniciues ishte shtetasi \*\*\*.\*\*\*, u gjet i drejtë nga Gjykata, duke treguar kështu se

<sup>15</sup> Për më tepër referohuni aktit: “Shpjegime dhe dokumentacion mbi relacionin e KPK-së”, të subjektit të rivlerësimit.

<sup>16</sup> Për më tepër referohuni në f. 14-16, të vendimit të Komisionit.

subjekti ka garantuar paanësinë e tij, nuk është përcaktuese, nëse ky përfundim nuk mbështetet në vlerësimin tërësor të provave.

33.2 Gjendja e konfliktit të interesit, në raport me provat e administruara, është gjendje fakti dhe, kur konstatohet si e tillë, për qëllim të procesit të rivlerësimit, duhet të vlerësohet në këndvështrim të etikës dhe vlerave profesionale të magjistratit, referuar ligjit nr. 96/2016, të ndryshuar, ligjit nr. 9367/2005, të ndryshuar, si dhe përcaktimeve të Kodit të Procedurës Penale, rast pas rasti. Referuar provave të administruara, përkundër sa arsyetohet në vendimin e Komisionit, në rastin konkret rezulton se:

- (i) Apartamenti është paguar nga subjekti i rivlerësimit në vitet 2006-2008.
- (ii) Subjekti i rivlerësimit ka bërë punime ndërtimi në apartament, në vitin 2010. Subjekti i rivlerësimit ka pasur kosto rinovimi në vitin 2009, duke treguar se apartamenti është bërë i banueshëm në këtë vit. Punimet konsistojnë në vendosjen e dyerve, shtrim dysHEMEJE, dritare (vetrata) dhe pajisje hidro-sanitare. Për sa kohë nuk ka tregues në kontratën e sipërmarrjes dhe atë të shitjes se subjekti i rivlerësimit e bleu apartamentin pa këto elemente, duket se subjekti i rivlerësimit ka ndërruar pajisjet ekzistuese.
- (iii) Në përgjigje të Pyetësorit<sup>17</sup> nr. 4, subjekti i rivlerësimit deklaroi se: “... unë me administratorin e shoqërisë nuk kishim finalizuar akoma detyrimet e ndërsjella midis nesh... Për këtë shkak, ne formalizuam detyrimet e ndërsjella me një dokument të veçantë, me Aktmarrëveshjen, që mban datën \*\*.2.2017”.

33.3 Sa më sipër, në rrethanat konkrete të rastit, në vlerësim të Komisionerit Publik, “detyrimet e ndërsjella” juridiko-civile mes subjektit të rivlerësimit dhe administratorit të shoqërisë “\*\*\*\*” sh.p.k. kanë nisur prej vitit 2006 e kanë përfunduar efektet e tyre në vitin 2017, moment në të cilin palët lidhin marrëveshjen dhe qartësojnë përfundimisht të drejtat dhe detyrimet e tyre reciproke. Në këto kushte, subjekti i rivlerësimit ka qenë i detyruar, për shkak të parashikimeve ligjore, të hiqte dorë nga hetimi i procedimit penal nr. \*\*\*, datë \*\*.6.2010, me qëllim shmangien e një situatë të konfliktit të interesit apo atij në dukje.

33.4 Në këtë kontekst, merr rëndësi dhe qëndrimi i subjektit të rivlerësimit në raport me detyrimin ligjor që ka pasur për të hequr dorë me veprime konkrete, e jo sikundër ka pretenduar gjatë hetimit administrativ, se për rastin ka vënë në dijeni drejtuesin e sektorit, pa paraqitur asnjë akt provues. Në këtë drejtim vlen të theksohet dhe praktika e Kolegjit në raste të ngjashme, vendimi (JR) nr. 10/2021, ku është mbajtur qëndrimi se: [45.] *Konflikti i interesit, sipas nenit 3, pika 1 e ligjit nr. 9367, datë 7.4.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, të ndryshuar, është gjendja e konfliktit ndërmjet detyrës publike dhe interesave privatë të një zyrtari, në të cilën ai ka interesa privatë, të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, që ndikojnë, mund të ndikojnë ose duket sikur ndikojnë në kryerjen në mënyrë të*

---

<sup>17</sup> Referuar këtij pyetësori, ndër të tjera, subjekti ka deklaruar se: “... Në kohën e firmosjes së kontratës, pavarësisht se sipërfaqja ishte më e madhe prej 11 m<sup>2</sup>, unë me administratorin e shoqërisë nuk kishim finalizuar akoma detyrimet e ndërsjella midis nesh, pra të detyrimit që shoqëria ndërtuese më detyrohej mua për vlerën e punimeve të kryera nga ana ime, në shumën prej 4.850 euro dhe vlerës korresponduese për sipërfaqen shtesë prej 11 m<sup>2</sup> në vlerë prej 4.752 euro, që kishte rezultuar nga matjet faktike. Për këtë shkak, ne formalizuam detyrimet e ndërsjella me një dokument të veçantë, me Aktmarrëveshjen që mban datën \*\*.2.2017. Në Aktmarrëveshje janë evidentuar zërat e punimeve të kryera nga unë, subjekti i rivlerësimit, në shumën prej 4.752 euro”.

*padrejtë të detyrave dhe përgjegjësive të tij publike. Një ndër rrethanat që mund të dëshmojnë konfliktin e mundshëm të interesit, janë marrëdhëniet e njohura të miqësisë [...]*<sup>18</sup>.

33.5 Për sa më sipër, Komisioneri Publik ndan qëndrim të ndryshëm nga vlerësimi që ka bërë Komisioni, duke konkluduar se subjekti nuk ka treguar kujdesin e duhur për të vlerësuar me objektivitet mundësinë e dorëheqjes, me qëllim shmangien e çdo dyshimi për paanësinë e tij, sipas një vlerësimi të një vëzhguesi të jashtëm të zakonshëm, fakt i cili duhet të çojë në një vlerësim negativ të indikatorit të integritetit dhe paanësisë, sipas përcaktimeve të nenit 75, të ligjit nr. 96/2016, të ndryshuar, apo dhe nga një vlerësim tërësor të çështjes, në kuptim të nenit 4, pika 2, të ligjit nr. 84/2016.

#### **V.C. Për kontrollin e figurës**

**34.** Kontrolli i figurës, si një ndër tri kriteret e rivlerësimit kalimtar, ka për qëllim identifikimin e atyre subjekteve që kanë kontakte të papërshtatshme<sup>19</sup> me persona të përfshirë në krimin e organizuar<sup>20</sup> apo atyre që kanë kryer deklaram të pasaktë<sup>21</sup> të të dhënave, sipas përcaktimeve të nenit DH të aneksit të Kushtetutës dhe Kreut V të ligjit nr. 84/2016.

**35.** Kontrolli i figurës bazohet në deklaratën që plotësohet dhe dorëzohet nga vetë subjekti dhe prova të tjera, përfshirë vendimet e gjykatave shqiptare dhe të huaja<sup>22</sup>. Bazuar në nenin 39 të ligjit nr. 84/2016, DSIK-ja fillimisht, me anë të raportit mbi kontrollin e figurës me nr. \*\*\* prot., datë \*\*.11.2017<sup>23</sup>, ka referuar për Komisionin: *“Përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës”*, të subjektit të rivlerësimit.

**36.** Në vijim, me kërkesë të Komisionit, DSIK-ja ka përcjellë raportin e dytë të përditësuar me nr. \*\*\* prot., datë \*\*.10.2021<sup>24</sup>, me anë të të cilit, në mënyrë të përmbledhur, informon se: [...] *Informacionet e ardhura nga institucionet e verifikimit në kohështrirje përpara periudhës së rivlerësimit na bëjnë me dije: “Subjekti i rivlerësimit, në vitin 2008, ka pasur një kontakt të papërshtatshëm/jorastësor me një person të përfshirë në trafikun e lëndëve narkotike, ku dyshohet se z. Gjon Kodra mund të jetë përfshirë edhe vetë në këtë aktivitet”... Në konfirmim të konstatimit fillestar për përshtatshmëri në vijimin e ushtrimit të detyrës për subjektin e rivlerësimit Gj. Kodra, gjykojmë që për rastin në fjalë konkluzioni të mbetet në vlerësimin tuaj, nën dritën e informacioneve të tjera që mund të dispononi [...].*

**37.** Komisioni, në cilësinë e organit që ka autoritetin kushtetues për të ushtruar kontroll të plotë mbi procesin e verifikimit të figurës, si dhe për të pasur akses në të gjitha materialet përkatëse, ka hetuar dhe ka vlerësuar të gjitha rrethanat dhe faktet e nevojshme, nga ku ka rezultuar se nga informacioni i vënë në dispozicion nga organet ligjzbatuese, datë \*\*.1.2018,

<sup>18</sup> Neni 5, pika 1 e ligjit nr. 9367/2005, përkatësisht germa “dh”, nënpika “v”.

<sup>19</sup> Referuar pikës 6, të nenit 3, të ligjit nr. 84/2016, *“kontakt i papërshtatshëm”* është një takim, komunikim elektronik ose çfarëdolloj mënyre tjetër takimi i qëllimshëm, që nuk është në pajtim me ushtrimin e detyrës nga subjekti i rivlerësimit...

<sup>20</sup> Referuar pikës 15, të nenit 3, të ligjit nr. 84/2016, *“person i përfshirë në krimin e organizuar”* është çdo person që është dënuar ose proceduar penalisht... me përjashtim të rastit kur është deklaruar i pafajshëm me vendim gjyqësor të formës së prerë.

<sup>21</sup> Sipas nenit DH, pika 4, paragrafi 2, *“Nëse subjekti i rivlerësimit përpiket të bëjë deklarime të pasakta ose të fshehë kontakte me persona të përfshirë në krimin e organizuar, zbatohet prezumimi në favor të masës disiplinore të shkarkimit dhe subjekti ka detyrimin të provojë të kundërtën”*.

<sup>22</sup> Paragrafi 2, i nenit DH, të aneksit të Kushtetutës.

<sup>23</sup> Deklasifikuar plotësisht me vendimin e Komisionit të Deklasifikimit dhe Zhvlerësimit të Informacionit të Klasifikuar (KDZH) nr. \*\*\*, datë \*\*.7.2021.

<sup>24</sup> Deklasifikuar pjesërisht me vendimin e KDZH-së, nr. \*\*\*, datë \*\*.10.2021.

nga shtetasi \*\*\*.\*\*\*, me numrin \*\*\* është kryer një bisedë telefonike me nr. \*\*\*, i regjistruar në emër të subjektit të rivlerësimit. Në vijim, Komisioni ka administruar shkresat e shoqërisë “\*\*\*\*” sh. a.,<sup>25</sup> me anë të të cilave konfirmohet se numrat e sipërcituar janë të regjistruar në emër të shtetasit \*\*\*.\*\*\* dhe subjektit të rivlerësimit.

**38.** Sikurse kemi referuar edhe në hyrje të këtij ankimi (prg. 8), gjatë hetimit administrativ, Komisioni ka administruar një *gjetje* së bashku me aneksin përkatës nga ana e vëzhguesit ndërkombëtar të ONM-së, në të cilën, në mënyrë të përmbledhur, parashtrohen dy elemente:

I. Mbi ekzistencën e standardeve ligjore, sipas të cilave:

- (i) Neni DH i aneksit të Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë i referohet periudhës “nga data 1 janar 2012 deri në ditën e deklarimit”, vetëm për plotësimin e deklaratës për figurën nga subjekti i rivlerësimit.
- (ii) Bazuar në nenin 38, pikat 4 dhe 6, të ligjit nr. 84/2016, vlerësimi i figurës bazohet në dy aspekte komplementarë të njëri-tjetrit, dhe përkatësisht, konstatimin e një kontakti të papërshtatshëm (“aspekti përmbajtësor”) dhe ai (“aspekti formal”) që lidhet me plotësinë dhe besueshmërinë e deklarimit.
- (iii) Mjaftueshmëria dhe vërtetësia e deklarimit kontrollohen për periudhën e deklaruar në Kushtetutë, ndërsa “aspekti përmbajtësor” i kontrollit të figurës, afati i tij mund të shtrihet edhe përpara datës 1 janar 2012.

Në vijim referohet vendimi i Kolegjit (JR) nr. 30/2019, në të cilin është mbajtur qëndrimi se: [...] *Ligji nr. 84/2016, neni 38, pika 5, shkronja “d”, parashikon një rrethanë lehtësuese, “kur kontaktet e subjektit të rivlerësimit kanë qenë pesë vjet më parë dhe nuk ka ndonjë tregues që ato vazhdojnë ende”. Kjo rrethanë mund të vlerësohet në raport me shkallën e seriozitetit të kontakteve dhe/ose me rrethanat e parashikuara në pikën 4 të këtij neni. Ky përkufizim e shtyn afatin e aspektit përmbajtësor të kontrollit figurës për kontaktet e papërshtatshme edhe përpara datës 1 janar 2012, por kjo duhet të konsiderohet si rrethanë lehtësuese, e cila më pas do të vlerësohet [...].*

II. Mbi faktin se, sipas dokumentacionit në dispozicion të vëzhguesit ndërkombëtar, një person, \*\*\*.\*\*\*, i lindur më \*\* tetor 1966, është dënuar me vendim të formës së prerë me 18 vite burgim (në vitin 2011), për trafikim të lëndëve narkotike dhe krim të organizuar në Itali. Personi ka përfutur, në Itali, nga e ashtuquajtura “*indulto*”, një masë falje, që mund të ulë dënimin, por nuk e shuan përgjegjësinë penale. Si pasojë, rezulton se dënimi përfundimtar është ulur me 2 vite dhe 5 muaj, dhe se personi është dëbuar nga Italia si masë sigurie.

**39.** Në konkluzion, vëzhguesi ndërkombëtar vlerëson se jurisprudenca e thekson qartë se “*aspekti përmbajtësor*” i vlerësimit të figurës mund të shtrihet përtej janarit 2012 dhe kontaktet e mëparshme të subjekteve me persona të përfshirë në krimin e organizuar duhet të merren parasysh. Megjithatë, ky “afat i shtrirë/i zgjatur” do të përbënte (së bashku me elementet e tjera specifike sipas rastit) një rrethanë lehtësuese. Nisur nga sa më sipër, Komisionit i rekomandohet të zbatojë gjetjet e paraqitura më lart në këtë dokument, në procesin e rivlerësimit të subjektit Gjon Kodra, dhe të vlerësojë ndikimin që ato mund të kenë në rezultatin (edhe në aspektin e vlerësimit të përgjithshëm) të këtij subjekti rivlerësimi.

**40.** Komisioni, pasi ka administruar dhe vlerësuar *gjetjen* e mësipërme të vëzhguesit ndërkombëtar, në referencë të nenit B, pika 3, germa “b”, e aneksit të Kushtetutës dhe nenit 49,

<sup>25</sup> Shkresat nr. \*\*\* prot., datë \*\*.10.2021, dhe nr. \*\*\* prot., datë \*\*.10.2021.

pikat 10 dhe 11, të ligjit nr. 84/2016, si dhe pasi ka administruar provat dhe shpjegimet e subjektit të rivlerësimit për të kundërtën e barrës së provës lidhur me to, në mënyrë të përmbledhur, ka vlerësuar se:

[...] *Komisioni, nisur nga vlerësimi tërësor i rrethanave, fakteve, provave dhe shpjegimeve të subjektit të rivlerësimit, në lidhje me kriterin e figurës, vlerëson se, pavarësisht se shtetasi \*\*\*. \*\*\* rezulton të ketë qenë person i përfshirë në krimin e organizuar, nuk rezulton e provuar në mënyrë të pakundërshtueshme që ky person të ketë qenë një kontakt i papërshtatshëm për subjektin e rivlerësimit. Ekzistenca e një telefonate në janar të vitit 2008 nga shtetasi \*\*\*.\*\*\*, në drejtim të subjektit, përveçse kohës së largët kur ka ndodhur dhe faktit se shtetasi \*\*\*.\*\*\* ka ndërruar jetë në vitin 2011, konstatohet të jetë një dhe e vetme, dhe për rrjedhojë, rastësore dhe nuk është vërtetuar që subjekti të ketë pasur kontakte të tjera të drejtpërdrejta apo të tërthorta dhe në vazhdimësi me këtë shtetas, si dhe fakti që në kohën e telefonatës në vitin 2008 nuk kishte asnjë informacion që shtetasi \*\*\*.\*\*\* ishte i përfshirë në veprimtari kriminale të trafikut ndërkombëtar të drogës. Subjekti i rivlerësimit ka qenë në padijeni të plotë të situatës ligjore të këtij personi dhe, për rrjedhojë, nuk mund të ngarkohet me përgjegjësi për pasje kontakti të papërshtatshëm dhe mosdeklarim të tij në deklaratën e kontrollit të figurës. Komisioni vlerëson se, duke marrë në konsideratë argumentet si më sipër, ekzistenca e një telefonate të vetme, pavarësisht përmbajtjes, nuk mund të arrijë një shkallë thelbësore dhe përcaktuese në vlerësimin e subjektit të rivlerësimit, qoftë për kriterin e figurës apo vlerësimin tërësor të tij, në kuadër të cenimit të besimit të publikut, deri në atë masë sa që ndaj tij të aplikohet masa disiplinore e shkarkimit nga detyra. Në përfundim, Komisioni vlerëson se subjekti i rivlerësimit ka arritur një nivel të besueshëm për kriterin e figurës dhe sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të aneksit të Kushtetutës, duke konfirmuar kështu përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës së subjektit të rivlerësimit Gjon Kodra [...] <sup>26</sup>.*

**41.** Komisioneri Publik, bazuar në Rekomandimin e ONM-së, përmbajtjen e gjetjes së vëzhguesit ndërkombëtar, e cila, referuar dispozitës së pikës 10, të nenit 49, të ligjit nr. 84/2016, përbën provë të barasvlershme me mendimin e një eksperti, duke e bërë këtë të fundit (gjetjen) pjesë të shkaqeve të ankimit, çmon se përfundimi i Komisionit nuk është rrjedhojë e një vlerësimi tërësor të fakteve dhe interpretimit të drejtë të ligjit të posaçëm. Duke vlerësuar një sërë mangësish të vërejtura, për kriterin e pasurisë, konstatimin e ekzistencës së konfliktit të interesit së bashku me problematikat për kriterin e figurës, kontaktit të papërshtatshëm, bazuar në një vlerësim të përgjithshëm të të tria kriterëve, apo vlerësim tërësor të çështjes, konstatohet se zbatimi i nenit 59, të ligjit nr. 84/2016, në rastin konkret, nuk është i bazuar.

**42.** Në përfundim të analizës së shkaqeve si më sipër, Komisioneri Publik vlerëson se kontrolli i Kolegjit në këtë rast është i nevojshëm, duke vlerësuar shkaqet e këtij ankimi, si dhe gjetjen në cilësinë e provës që dëshmon faktin, rrethanën apo standardin ligjor të parashtruar në të.

## **VI. Kërkimi i ankimit**

**43.** Nisur nga parashikimi i nenit 179/b/5 të Kushtetutës, aneksit të Kushtetutës, konsiderojmë se, ndryshe nga sa disponon Komisioni i Pavarur i Kualifikimit për kriteret e

<sup>26</sup> Për më tepër referohuni në f. 57-59, të vendimit të Komisionit.



rivlerësimit, referuar gjendjes së fakteve dhe provave në rastin konkret, Komisioneri Publik ndan gjykim të kundërt, pasi vlerëson se subjekti i rivlerësimit nuk arrin nivel të besueshëm për konfirmimin e tij në detyrë, në kuptim të nenit 59/1, të ligjit nr. 84/2016.

**44.** Duke ritheksuar se Komisioneri Publik ka detyrimin që të ushtrojë kontroll mbi vendimet e dhëna nga Komisioni, me qëllim që të garantojë mbrojtjen e interesit publik në procesin e rivlerësimit, duke vlerësuar në qoftë se vendimmarrja e Komisionit për konfirmimin ose shkarkimin e subjektit, ose ndërprerjen e procesit të rivlerësimit është marrë në përputhje me ligjin, në përfundim të një hetimi të plotë, mbështetur në faktet dhe provat e administruara për këtë qëllim;

**45.** Bazuar në kërkesat e neneve Ç, D, DH, E dhe F, të aneksit të Kushtetutës, neneve 30-39, 40-44, pikave 3 dhe 5, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016;

Kërkojmë që shkaqet e këtij ankimi të merren në shqyrtim nga ana e Kolegjit dhe, në zbatim të nenit 66, pika 1, germa “b”, të ligjit nr. 84/2016, të vendosë:

- Ndryshimin e vendimit nr. 491, datë 21.12.2021, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, dhe shkarkimin nga detyra e subjektit të rivlerësimit, zotit Gjon Kodra.

## **KOMISIONERI PUBLIK**

**Florian BALLHYSA**

I bashkëlidhet këtij ankimi:

1. Rekomandimi nr. 36/1 prot., datë 25.1.2022, i një Komisioni prej tre përfaqësuesish të ONM-së.



**International Monitoring Operation**  
*Project for the Support to the Process of Temporary  
Re-evaluation of Judges and Prosecutors in Albania*



Prot. No. 36/1

Tirana, 25 January 2022

**To the  
Public Commissioners**  
Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”, Nr. 6  
Tirana  
Albania

Case Number            **DC-P-TIR-1-11**

Assessee                **Gjon KODRA**

**RECOMMENDATION TO FILE AN APPEAL**

**According to**

Article B, par. 3, point c of the Constitution of the Republic of Albania (hereinafter “Constitution”), Annex “Transitional Qualification Assessment”, and Article 65, par. 2 of Law No. 84/2016 “On the transitional re-evaluation of judges and prosecutors in the Republic of Albania” (hereinafter “Vetting Law” or “VL”).

## 1. Introduction and Scope of the Recommendation

Gjon KODRA has been assessed by the Independent Qualification Commission (hereinafter "IQC") pursuant to Article 179/b, par. 3 of the Constitution and in accordance with the provisions of the Vetting Law. With decision dated \_\_\_\_\_ the IQC decided to confirm the assessee in office.

The International Observers (further: "IOs" or "IMO") recommend the Public Commissioners (further: "PCs") to file an appeal against the entirety of the results reached by the IQC. The IOs believe that a correct assessment of all the issues of the case should result in a dismissal of the assessee, as the assessee does not reach a trustable level of asset assessment pursuant to Art. 59, par. 1, point a of the Vetting Law.

In addition, the IQC failed to properly consider the existence of a conflict of interest situation in the case at stake, as it will be described below in the text of the Recommendation.

Last, but not least, the IQC did not evaluate the background assessment in line with the IO's finding on the case dated 8 November 2021 which should have been taken in consideration, at least, in the framework of the overall assessment of the proceeding in line with Art. 61, par. 5 of the VL.

## 2. Grounds of the Recommendation

The IOs believe that the PCs should appeal the results of the three pillars in their entirety, to permit – for the assets assessment - the Special Appeal Chamber to undertake the full financial analysis of all the years which will also allow to properly verify the IOs' concerns on the further below issues.

Moreover, a proper evaluation of the background assessment should be undertaken to allow the Special Appeal Chamber to consider, within the framework of the overall assessment of the proceeding, the correct application of art. 61, par. 5 of the Vetting Laws, also in light of the correct identification of a conflict of interest situation in the case involving \*\*\* \*\*.

### Issues in the asset assessment

**A) Apartment with an area of 129 m<sup>2</sup> at \*\*\* street, building \*\*\* sh.p.k, entrance \*\*Ap. \*\*, Tirana; purchased under the sale-purchase contract dated \*\*\*.10.2016<sup>1</sup>. Price EUR 50,952. Share 100%.**

With regards to the analysis of the EUR 30,000 paid in 2006 and EUR 5,000 paid in 2007 from the spouse's income, IMO would like to point out that:

- The savings were not declared in the first three annual declarations (from 2003 to 2005);
- There appears to be no evidence of the existence of the aforementioned savings (such as bank deposits); during the hearing, the assessee declared that he did not ask his spouse

<sup>1</sup> Sale-purchase contract with rep. No.\*\*\* col. No. \*\*\* , dated \*\*\*10.2016, ownership certificate No. \*\*\* , issued on \*\*\*10.2016.



about the savings she had before marriage. Furthermore, he confirmed that the savings were kept in Italy – not in Albania - but it appears that the assessee had no further knowledge of where the savings were kept;

- It appears that there is no traceable evidence of the modalities used to transfer the money to Albania.

Considering the above, IMO would like to point out that there is no evidence whatsoever on the existence of the 35,000 Euro and, as such, they should not be considered as legal sources for the relevant assets.

Moreover, the justifications provided by the assessee do not stand, as his position in the judiciary and his duties to complete the first assets declarations (from 2003 to 2005) imposed some obligations to declare the assets and its sources; obligations which cannot be simply evaded by saying that he did not know the wife's savings prior to the marriage.

#### **B) Existence of a conflict of interest related situation**

- It appears that the assessee was in a conflict of interest situation when he investigated the case involving \*\*\*\*\*, administrator of the \*\*\* sh.p.k Company with whom the assessee had a relation of interest - as well as ongoing social relations.

IMO would like to point out that the IQC decision (page 16 - paragraph 2.10.12 - of the Albanian version, as translated by IMO) reads as follows:

*“The Commission notes that the real relation of interest between assessee and the administrator/sole partner of “ \*\*\* ” shpk company, Mr. \*\*\*\*\*, ended in 2008 with the payment of the full purchase price of the apartment EUR 50,952, same price specified in the final apartment sale/purchase contract of 2017. The value of works carried out by assessee, which served to compensate the extra surface area of 11 m2 is an element emerging unexpectedly in 2017 before the conclusion of final sale contract, but which was in fact resolved at the same time with the signing of this contract in 2017. Assessee's claim that he was careful enough to notify the head of institution about the relationship he had with the complainant is of a declarative nature and ungrounded [...]*

*But on the other hand, the Commission takes into account the fact that this relation of interest besides of having ended in 2008 (meanwhile the criminal case belongs to the period 2010-2011) when the purchase price was fully paid by assessee, was not proven to be in itself a preferential treatment, what could have led to the application of a low/preferential price by the company “ \*\*\* ” shpk in favor of assessee. On the contrary, by submitting to the Commission the similar contracts on facilities located in the same apartment block assessee did convincingly prove that the price he paid was real, very similar to the respective prices in similar contracts and not a preferential price.”*

IMO would like to point out that, in the replies to the questionnaire No.4 (at p. 5 of the Albanian version, as translated by IMO), the assessee states:

*“With reference to specifying the date of payment for the works that were carried out and the purchase of household appliances, which amounted to EUR 4,850, I would like to inform you that the payments were made on different dates, for which no invoices or bills are available to me.*

*The payments of this amount were made during 2010 and as it is known from all the citizens (well-known facts) the companies did not issue invoices for the sales to the end consumers (individuals). The companies have started to issue invoices to end consumers (individuals) only during these last 4-5 years, following an extensive awareness campaign that was launched.*

*I have provided clarifications regarding the legitimate source of the amount of EUR 4,850 even in the replies to the previous questionnaire; also, in order to provide clarifications, which were requested from the Commission, I would like to inform you that I paid for the works, which were carried out and included in the contract certificate dated .02.2017, with the loans I received from the citizens and in 2010. Since it was noted in the Title Deed that the apartment measured 129 m<sup>2</sup>, thus, 11 m<sup>2</sup> more than the order I placed initially for an apartment measuring 118 m<sup>2</sup>, and since I had started to live in that apartment when the final sales contract was drafted, which served as a document for conveyance of property from “ Company to the new owner, , despite the surface area of the apartment was 11 m<sup>2</sup> more than I had ordered when we signed the contract, the administrator of the construction company and I had not finalized the mutual liabilities, thus, the liability of the construction company to me regarding the cost of works I carried out, which amounted to EUR 4.850 and the relevant cost of works I carried out in the additional surface area measuring 11 m<sup>2</sup>, which amounted to EUR 4.752, pursuant to the factual measurements that were taken. Due to this reason, we formalized our mutual liabilities in a specific document, the contract certificate that we concluded on .02.2017. The works, which I, the Assessee, carried out in the apartment and which amounted to EUR 4.752, were itemized in the Contract Certificate.”*

IQC concludes (at p. 16 of the Albanian version of the decision, as translated by IMO) that

*‘the real relation of interest between assessee and the administrator/sole partner of “ ” shpk company, Mr. , ended in 2008 with the payment of the full purchase price of the apartment’.*

However, from the information provided during the investigation process, it was possible to ascertain that:

- The apartment was paid in the years 2006-2008;
- The assessee has made construction works in the apartment in 2010. The assessee had refurbishing costs in 2009 – indicating that the house was made livable in 2009. These construction works consisted of putting 7 doors, a layer in the floor, windows



("vetrata"), and bathroom equipment. There is no indication in the off-plan contract and in the sales contract that the assessee purchased the apartment without these elements and, therefore, it is possible to conclude that the assessee changed the existing ones;

- In the replies to the 4<sup>th</sup> questionnaire the assessee stated (at p. 5 of the Albanian version of the replies, as translated by IMO) that

*"the administrator of the construction company and I had not finalized the mutual liabilities",*

And this leads to the belief that the amount of 4.850 EURO which was paid in 2010 were a liability by the construction company;

- In 2017 the assessee gets 11 m2 additional ownership on the apartment, for which he paid no money due to the construction works done in 2010.

Contrary to IQC's conclusion, it seems that the relation of interest between the assessee's and \*\*\*\* had not ended in 2008, but it rather continued in 2010, and further on in 2016 when the purchase contract was finalised.

Therefore, the conclusion in p. 16 of the Albanian version of the IQC decision (as translated by IMO) stands. More precisely, although IMO disagrees on the IQC's conclusion according to which the relation of interest ended in 2008 (because it continued until 2010), it is possible to agree with the IQC's statement according to which

*"Assessee's claim that he was careful enough to notify the head of institution about the relationship he had with the complainant is of a declarative nature and ungrounded".*

### **C) As to the background assessment**

The IMO would like to refer to the finding dated 8 November 2021 and relevant Annex filed by the International Observer of the case which had to be considered by the IQC in the final decision and which was not properly addressed in it, including in the framework of the overall assessment of the proceeding.

### **3. Conclusions**

One of the purposes of the re-evaluation process is to restore the public trust in the institutions of the justice system. In IMO's view it is impossible to confirm an assessee in duty when several issues have not been correctly assessed.

As demonstrated in this Recommendation, these issues revolve around the assets, background, proficiency (ethic in connection with a conflict of interest situation) and overall assessment of the proceeding.

IOs believe that a proper consideration of all elements should result in a dismissal of the assessee due and, in view of the above, the IMO recommends an appeal against IQC's decision in this case.

International Observer

International Observer

~~International Observer~~

